



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.267/2017

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Fejzullah Rexhepi kryesues, Ymer Hoxha dhe Zyhdi Haziri anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarit ligjor Bajram Rexhahmetaj, duke vendosur lidhur me ankesën e Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, paraqitur kundër Koalicionit PDK-AAK-NISMA, me seli në Prishtinë, për shkak të fotografimit të votës në vendvotim, gjatë ditës së votimit, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me 13.06.2017, mori këtë:

## V E N D I M

**Refuzohet si e pabazuar** ankesa Anr.267/2017 e datës 12.06.2017, me të cilin është pretenduar se, nga ana e **Koalicioni PDK-AAK-NISMA**, është bërë fotografimi i votës në vendvotimin 1512E/01R, në *Kastriot* në ditën e zgjedhjeve.

## A r s y e t i m

Parashtruesi i ankesës, subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, me datën 12.06.2017, ka parashtruar ankesë në PZAP, me të cilën pretendohet se me datën 11.06.2017 gjatë ditës së zgjedhjeve, komisioneret e Lëvizjes Vetëvendosje nga vendvotimi 1512E/01R, Kastriot, ka konstatuar se është bërë fotografimi i votës, ku në këtë rast është bllokuar edhe vendvotimi. E njëjta shkelje është konstatuar në Librin e votimit. Për këtë në kuptim të dispozitës së Kodit Penal të Republikës së Kosovës, neni 218, paragrafi 2, cenimi i fshehtësisë së votimit, fotografimi i votës përbën shkelje të dispozitave ligjore të lartë cekura. Sipas kësaj anëtarët e KVV-së, nën dyshimin e arsyeshëm kanë kryer veprën penale nga neni 218 paragrafi 2 i Kodit Penal.

PZAP-i, pas shqyrtimit paraprak të bazueshmerisë së ankesës dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore, që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenin 117 par.2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

### **Ankesa është e pabazuar**

Paneli vlerëson se parashtruesi i ankesës në mbështetje të pretendimeve në ankesë nuk ka ofruar dëshmitë të qarta dhe bindëse për të vërtetuar pretendimet ankimore edhe pse barra e te provuarit bie mbi parashtruesin e ankesës, në kuptim të nenit 117 par.3 të LZP-së, për te

provuar pretendimet ankimore. Sepse nga ankesa e ofruar nuk mund të identifikohet në mënyrë bindëse dhe të qarte të dhënat e shfaqur nga fotografimi i votës dhe nuk janë ofruar materiali nga librit i votimit, për këtë arsye është vendosur si ne dispozitiv të këtij vendimit. Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë nenin 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

Anr.267 /2017 më datën 13.06.2017



**Këshillë juridike:** *Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur, mund të paraqet ankesë brenda afatit prej njëzet e katër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimimit të këtij vendimi në Gjykatën Supreme.*

**Kryesuesi i Panelit  
Fejzullah Rexhepi**